

VENDIM
Nr.1563, datë 26.11.2008

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KAVAJË, TË QARKUT TË TIRANËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, dhe të neneve 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Kavajë, të qarkut të Tiranës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr.1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 112 (njëqind e dymbëdhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 690 (gjashtëqind e nëntëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia e Kavajë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kavajë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2,10,19,20	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e administratës	Në pronësi
113-117,119,121-126	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
156	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik	Në pronësi
128-151	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
320-322	Varrezat publike	Në pronësi
385,386,388,389,392	Infrastrukturë (troje të lira)	Në përdorim
323-366,367-384,387,390,391,393,394,395-689	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
33	Prona që përdoren në fushën e shërbimit social	Në pronësi
159-176,178-192	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik	Në pronësi
35-49	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
243,245	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
239,244	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive)	Në pronësi
308	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ndriçimit publik	Në pronësi